**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM**
**TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**
**KËSHILLI ADMINISTRATIV**
Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksh.com.al

# VENDIM

**Nr. 60, datë 17.07.2017**

## "PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PERSONELIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, NË KAPITULLIN 'PAGA'"

Mbështetur në nenin 20, shkronja "ë", të Ligjit Nr. 10 383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 5, shkronja "h", të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 187, datë 08.03.2017, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit*" me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ:

## VENDOSI:

1. Pagat e personelit të Drejtorisë Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Drejtoritë Rajonale të Fondit, Degët, Agjencitë e Drejtorive Rajonale, Drejtoria Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor, në **"Rregulloren e Personelit" 3.3, Kapitulli X - pagat pika 5**, bëhen këto ndryshime:
   a) Për Drejtorinë Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:
      - ishte 30,718;
      - bëhet 33,790 lekë.
   
   b) Për Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë:
      - ishte 29,012;
      - bëhet 31,913 lekë.
   
   c) Për Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Kaméz-Vorë:
      - ishte 29,012;
      - bëhet 31,913 lekë.
   
   d) Për Drejtoritë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
      - ishte 27,305;
      - bëhet 30,036 lekë.

e) Për Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:
- ishte 27,305;
- bëhet 30,036 lekë.

f) Për Agjencitë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:
- ishte 27.305;
- bëhet 30,036 lekë.

g) Për Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe Kontrollit Spitalor:
- ishte 30,149;
- bëhet 33,164 lekë.

2. **Kapitulli X - Pagat, pika 4** - Raportet e pagës bazë të çdo klase me klasën më të ulët bëhen si më poshtë:

- **Për Drejtorinë Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësore:**
  Kategoria A

| Niveli | Klasa | Raporte Ishte | Raporte Bëhet |
|---|---|---|---|
| 1 | I-1 | 1.00 | 1.00 |
| 2 | I-3 | 1.44 | 1.44 |
| 3 | I-4 | 1.52 | 1.52 |
| 4 | I-5 | 1.72 | 1.72 |
| 5 | II-2 | 1.94 | 1.90 |
| 6 | II-3 | 2.29 | 2.25 |
| 7 | II-4 | 2.75 | 2.70 |
| 8 | II-5 | 3.25 | 3.19 |
| 9 | III-4 | 3.89 | 3.79 |
| 10 | III-5 | 4.16 | 4.08 |

- **Për Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Tiranë;**
- **Për Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Kamëz-Vorë.**
  Kategoria B

| Niveli | Klasa | Raporte Ishte | Raporte Bëhet |
|---|---|---|---|
| 1 | I-1 | 1.00 | 1.00 |
| 2 | I-3 | 1.12 | 1.12 |
| 3 | I-5 | 1.39 | 1.39 |
| 4 | II-1 | 1.58 | 1.55 |
| 5 | II-2 | 1.89 | 1.85 |
| 6 | II-3 | 1.98 | 1.95 |
| 7 | II-4 | 2.24 | 2.20 |
| 8 | II-5 | 2.54 | 2.50 |
| 9 | III-4/1 | 3.29 | 3.20 |
| 10 | III-4 | 4.12 | 4.01 |

- **Për Rrejtoritë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:**
  Kategoria C

| Niveli | Klasa | Raporte Ishte | Raporte Bëhet |
|---|---|---|---|
| 1 | I-1 | 1.00 | 1.00 |
| 2 | I-3 | 1.17 | 1.17 |
| 3 | I-5 | 1.35 | 1.35 |
| 4 | II-1 | 1.64 | 1.61 |
| 5 | II-2 | 1.90 | 1.87 |
| 6 | II-3 | 2.02 | 1.98 |
| 7 | II-4 | 2.29 | 2.25 |
| 8 | II-5 | 2.45 | 2.40 |
| 9 | III-3 | 2.86 | 2.78 |
| 10 | III-4/1 | 3.49 | 3.40 |

- **Për Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:**
  Kategoria C/1

| Niveli | Klasa | Raporte Ishte | Raporte Bëhet |
|---|---|---|---|
| 1 | I-1 | 1.00 | 1.00 |
| 2 | I-3 | 1.17 | 1.17 |
| 3 | I-5 | 1.35 | 1.35 |
| 4 | II-1 | 1.64 | 1.61 |
| 5 | II-2 | 1.90 | 1.87 |
| 6 | II-3 | 2.02 | 1.98 |
| 7 | II-4 | 2.29 | 2.25 |
| 8 | II-5 | 2.45 | 2.40 |
| 9 | III-2 | 2.83 | 2.75 |

- **Për Agjencitë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:**
  Kategoria C/2

| Niveli | Klasa | Raporte Ishte | Raporte Bëhet |
|---|---|---|---|
| 1 | I-1 | 1.00 | 1.00 |
| 2 | I-3 | 1.08 | 1.08 |
| 3 | I-5 | 1.25 | 1.25 |
| 4 | II-1 | 1.52 | 1.49 |
| 5 | II-2 | 1.76 | 1.73 |
| 6 | II-3 | 1.87 | 1.84 |
| 7 | II-4 | 2.13 | 2.09 |
| 8 | III-1 | 2.45 | 2.38 |

- **Për Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe Kontrollit Spitalor**
  Kategoria D

| Niveli | Klasa | Raporte Ishte | Raporte Bëhet |
|---|---|---|---|
| 1 | I-1 | 1.00 | 1.00 |
| 2 | I-3 | | 1.16 |
| 3 | I-5 | 1.66 | 1.72 |
| 4 | II-2 | 1.96 | 1.92 |
| 5 | II-3 | 2.31 | 2.72 |
| 6 | II-4 | 2.77 | 2.72 |
| 7 | II-5 | 3.30 | 3.24 |
| 8 | III-4/1 | 3.52 | 3.43 |
| 9 | III-4 | 3.93 | 3.82 |

Mbi bazën e pagës bazë të Nivelit I-1 dhe raporteve të niveleve të tjera me Nivelin më të ulët ndërtohet tabela e pagave (Aneks), bashkëngjitur këtij Vendimi.

3. Në Kapitullin X "Pagat" pika 6 gërma (d), Shtesat për vështirësi në punë mbi pagën bazë për pozicioni Drejtor i Drejtorisë Ekonomike
   - ishte 15%
   - bëhet 12.5%

4. Ky vendim hyn fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 01.03.2017.

**KRYETAR I KËSHILLIT ADMINISTRATIV**

**MIRA RAKACOLLI**

TIRANË

Ermira Qelo

Matilda Dzepeni

## ANEKS

**Tabela e pagave për drejtorinë qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shendetësor Kategoria A**

( në lekë )

| Nr | EMËRTIMI | Klasa | Paga ( në lekë) |
|---|---|---|---|
| 1 | Zv. Drejtor i Përgjithshëm | III-5 | 137,847 |
| 2 | Drejtor Drejtorie, Zëdhënëse e Shtypit | III-4 | 127,976 |
| 3 | Përgjegjës sektori, Asistente e Drejtorit të Përgjithshëm | II-5 | 107,939 |
| 4 | Specialist i lartë me mbi 12 vjet në punë | II-4 | 91,181 |
| 5 | Specialist i lartë me 6-12 vjet në punë | II-3 | 76,032 |
| 6 | Specialist i lartë me 0-6 vjet punë,infermier | II-2 | 64,321 |
| 7 | Operator, protokollist-arshivist | I-5 | 58,082 |
| 8 | Magazinier | I-4 | 51,513 |
| 9 | Shofer, punonjës mirëmbajtje | I-3 | 48,584 |
| 10 | Pastruese | I-1 | 33,790 |

**Tabela e pagave për drejtorine rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shendetësor, Tiranë dhe drejtorine rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shendetësor, Kamëz - Vorë**
**Kategoria B**

( në lekë )

| Nr | EMËRTIMI | Klasa | Paga ( në lekë) |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor i Drejtorisë Rajonale | III-4 | 127,976 |
| 2 | Zv.Drejtor i Drejtorisë Rajonale | III-4/1 | 102,017 |
| 3 | Pergjegjes sektori | II-5 | 79,726 |
| 4 | Specialist i lartë me mbi 12 vjet në punë | II-4 | 70,236 |
| 5 | Specialist i lartë me 6-12 vjet në punë | II-3 | 62,184 |
| 6 | Specialist i lartë me 0-6 vjet në punë | II-2 | 59,072 |
| 7 | Specialist shpërndarjeje librezash, Arkëtar - kartelist, Sekretare, Specialist i mesëm | II-1 | 49,623 |
| 8 | Operator, Protokollist -magazinier , arshivist | I-4 | 44,266 |
| 9 | Shofer, punonjës mirëmbajtje | I-3 | 35,874 |
| 10 | Pastruese | I-1 | 31,913 |

**Tabela e pagave për drejtorite rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shendetësor**
**Kategoria C**

( në lekë )

| Nr | EMËRTIMI | Klasa | Paga ( në lekë ) |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor i Drejtorisë Rajonale | III-4/1 | 102,017 |
| 2 | Zv.Drejtor i Drejtorisë Rajonale | III-3 | 83,571 |
| 3 | Pergjegjes sektori | II-5 | 72,157 |
| 4 | Specialist i lartë me mbi 12 vjet në punë | II-4 | 67,534 |
| 5 | Specialist i lartë me 6-12 vjet në punë | II-3 | 59,466 |
| 6 | Specialist i lartë me 0-6 vjet në punë | II-2 | 56,042 |
| 7 | Specialist i mesëm | II-1 | 48,343 |
| 8 | Operator,Arketar,Protokollist-arshivist-magazinier,shpërndarës librezash | I-4 | 40,662 |
| 9 | Shofer | I-3 | 35,087 |
| 10 | Pastruese | I-1 | 30,036 |
| | | | |

**Tabela e pagave për deget e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shendetësor, Kategoria C/1**

( në lekë )

| Nr | EMËRTIMI | Klasa | Paga ( në lekë) |
|---|---|---|---|
| 1 | Kryetar Dege | III-2 | 82,679 |
| 2 | Zv.kryetar dege | II-5 | 72,157 |
| 3 | Specialist i lartë me mbi 12 vjet në punë | II-4 | 67,534 |
| 4 | Specialist i lartë me 6-12 vjet në punë | II-3 | 59,466 |
| 5 | Specialist i lartë me 1-6 vjet në punë | II-2 | 56,042 |
| 6 | Specialist i mesëm | II-1 | 48,343 |
| 7 | Arkëtar | I-5 | 40,662 |
| 8 | Shofer | I-3 | 35,087 |
| 9 | Pastruese | I-1 | 30,036 |

**Tabela e pagave per agjensite e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shendetësor,**

**Kategoria C/2**

( në lekë)

| Nr | EMËRTIMI | Klasa | Paga ( në lëkë ) |
|---|---|---|---|
| 1 | Pergjegjes Agjensie | III-1 | 71,475 |
| 2 | Specialist i lartë me mbi 12 vjet në punë | II-4 | 62,822 |
| 3 | Specialist i lartë me 6-12 vjet në punë | II-3 | 55,129 |
| 4 | Specialist i lartë me 0-6 vjet në punë | II-2 | 51,956 |
| 5 | Specialist i mesëm | II-1 | 44,699 |
| 6 | Protokolliste-arshiviste-magazinier | I-5 | 37,582 |
| 7 | Shofer | I-3 | 32,402 |
| 8 | Pastruese | I-1 | 30,036 |

**Tabela e pagave për drejtorinë e Sigurimeve të Kujdesit Shendetesor pranë QSUT**
**Kategoria D**

( në lekë )

| Nr | EMËRTIMI | Klasa | Paga ( ne leke ) |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor Drejtorie | III-4 | 126,733 |
| 2 | Zv/Drejtor | III-4/1 | 113,661 |
| 3 | Pergjegjes Sektori | II-5 | 107,443 |
| 4 | Specialist i lartë me mbi 12 vjet në punë | II-4 | 90,304 |
| 5 | Specialist i lartë me 6-12 vjet në punë | II-3 | 75,301 |
| 6 | Specialist i lartë me 0-6 vjet në punë | II-2 | 63,702 |
| 7 | Operator | I-5 | 57,007 |
| 8 | Shofer | I-3 | 38,500 |
| 9 | Pastruese | I-1 | 33,164 |

Ermira Vila
Merita Dylgjeri

# RELACION

## MBI PROJEKT VENDIMIN "PËR RRITJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË FSDKSH PËR VITIN 2017"

Në mbështetje të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 10 gërma "e", të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, propozon në Këshillin Administrativ të Fondit, miratimin e Projekt-vendimit të Këshillit Administrativ "Për rritjen e pagave të punonjësve në Drejtorinë Qëndrore, Drejtoritë Rajonale, Degët dhe DSHSUKS".

Në vijim po ju paraqesim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për rritjen e pagave të punonjësve të FSDKSH për vitin 2017.

Materiali i propozuar ka si qëllim jo vetëm të realizojë rritjen në shkallë absolute të nivelit të pagave, por dhe të përmirësojë më tej raportet e pagave midis klasave, në favor të pagave të nivelit të mesëm dhe të ulët. Kështu, rritja e propozuar sipas klasave të ndryshme varion nga 7%- 10 %, në linjë me politikën qeveritare për masën e rritjes së pagave në administratën publike. Konkretisht, po paraqesim me hollësi rritjen për çdo grup.

1. Për kategoritë e punonjësve që i përkasin këtyre klasifikimeve: *Drejtor Drejtor*ie në FSDKSH; *Drejtor dhe Zv./Drejtor*, *Kryetar Dege* në Drejtoritë Rajonale, parashikohet rritje në masën 7 %. Për pagën e Zv/Drejtorit të Përgjithshëm është aplikuar një rritje 8%, me qëllim ruajtjen e një raporti me pagën e Drejtorit të Përgjithshëm, e cila përcaktohet me VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit*".

2. Për kategoritë e punonjësve që i përkasin klasifikimeve : *përgjegjës sektori dhe specialistë* në FSDKSH, Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor pranë QSUT, në Drejtori Rajonale, parashikohet një rritje prej 8 %.

3. Për kategoritë e punonjësve që i përkasin grupit të specialistëve të mesëm, duke përfshirë emërtimet pastruese, shofer, magazinjer, operator, protokollist, arshivist, arkëtar, shpërndarës kartash shëndeti, parashikohet rritje 10 %.

Kjo rritje e diferencuar, në një masë më të madhe për kategoritë më të ulta bëhet për të zbutur disnivelin e theksuar që ekziston midis pagave të nivelit të ulët me nivelet e tjera.